

TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME – TKP

Reiseburo Prishtina International Sh.P.K.

Nënë Tereza 25/a

10000-Prishtinë

Kosovë

Pronar: Agnesa Aliji

Nr. i biznesit: 811398727

1. Juridiksioni i kushteve të përgjithshme të biznesit

Të gjitha shërbimet e Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. pasojnë vetëm në bazë të kushteve të përgjithshme të biznesit në vijim. Përjashtimet nga këto kushte të biznesit janë të vlefshme, vetëm atëherë kur janë bërë si marrëveshje me shkrim dhe janë vërtetuar nga ne, po ashtu me shkrim.

2. Oferta dhe lidhja e kontratës

Ofertat në sistemin tonë online të rezervimit paraqesin kërkesë joobligative për klientin. Duke u lajmëruar përmes formularit tonë online të rezervimit, klienti ofron në formë të obligueshme lidhjen e kontratës për transport sipas kushteve të vlefshme të transportimit të Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. Përmes pranimi nga Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. vjen deri te realizimi i kontratës së transportimit. Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. e kumton pranimin me anë të dërgimit të një vërtetimi rezervimi përmes e-mailit. Kumtimi i pranimi të kontratës mund të pasojë edhe joformalisht, p.sh. përmes verprimit vendimtar (p.sh. ngarkimi i kartelës kreditore).

3. Kushtet e pagesës

Vlejnë çmimet, të cilat kanë qenë prezente e janë konfirmuar gjatë rezervimit. Pagesa realizohet vetëm nëpërmes një kreditkarte të pranuar nga Reiseburo Prishtina International Sh.p.k.. Pas pranimi të konfirmimit të rezervimit, i gjithë çmimi i biletës duhet të paguhet, gjë që ndodh dhe me këtë ngarkohet kontoja e kreditkartës së dhënë. Nëse banka ose instituti i kreditkartelave e refuzon pagesën, Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. është e autorizuar që ta ndërpresë menjëherë kontratën dhe që ta anulojë rezervimin.

4. Mbrojtja e të dhënave personale

Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. garanton konfidencialitet të plotë për të gjitha të dhënat e pranuar nga klienti.

5. Kushtet e rezervimit

5.1 Rezervimi mund të bëhet online në faqen tonë të internetit (www.flyrbp.com) ose në Qendrën e thirrjeve të Reiseburo Prishtina sh.p.k.. Në varësi të llojit të rezervimit, pasagjeri do të marrë konfirmimin e rezervimit me email, SMS ose mjete të tjera pasi i njëjti do të bëhet , përfundohet në tërësi. Konfirmimi i rezervimit duhet të përmbajë numrin e rezervimit, emrin e pasagjerit, informacionin e fluturimit, dhe shënime tjera të nevojshme sa i përket udhëtimit.

5.2 Rezervimi do të konsiderohet i pranuar nga Reiseburo Prishtina sh.p.k. në momentin kur pasagjeri që do të transportohet ka marrë konfirmimin e rezervimit me email, SMS ose aplikacione tjera si (WhatsApp, Viber etj.). Në rastin e rezervimeve të bëra me telefon në Qendrën e thirrjeve të Reiseburo Prishtina sh.p.k., deklarata e pranimit mund të bëhet edhe në mënyrë joformale duke transmetuar konfirmimin e rezervimit me telefon ose me ndonjë veprim tjetër përfundimtar.

5.3 Pasagjeri është i detyruar të kontrollojë menjëherë konfirmimin e rezervimit të pranuar ose të transmetuar me telefon për saktësinë dhe, nëse është e nevojshme, të njoftojë Reiseburo Prishtina sh.p.k. për çdo pasaktësi, mospërputhje ose mospranim të konfirmimit. Njoftimi i vonuar i pasaktësive ose mospërputhjeve nuk i jep të drejtë pasagjerit të anulojë rezervimin.

5.4 Do të zbatohen shërbimet dhe tarifat e konfirmuara në momentin e rezervimit. Çmimet e fluturimeve të publikuara në faqen e internetit (www.flyrbp.com) përshtaten rregullisht dhe mund të ndryshojnë varësisht nga kërkesa (numri i vendeve të shitura me një tarifë dhe kalimi automatik në tarifën tjetër , të përcaktuara në planifikimin e fluturimit në datën konkrete) . Ofertat speciale të promovuara vlejnë për një periudhë të caktuar udhëtimi dhe me një kufizim kohor.

5.5 Transporti do të bëhet vetëm me paraqitjen e dokumenteve të plota dhe të vlefshme të udhëtimit (pasaportë, letërnjoftim, kod rezervimi, etj.). Çdo pasagjer është përgjegjës për respektimin e rregulloreve që lidhen me udhëtimin. Rimbursimi i tarifës ajrore përjashtohet në rast të mosrespektimit të rregulloreve të hyrjes dhe daljes, të cilat për pasojë çojnë në refuzimin e pasagjerit për hyrje në një shtet të caktuar.

5.6 Nëse pasagjerit i refuzohet hyrja në një shtet, ai/ajo është i detyruar të paguajë të gjitha shpenzimet e bëra për transportin jashtë atij shteti. Tarifa nuk do të kthehet në raste të tilla.

5.7 Rezervimi duhet të bëhet në emër të pasagjerit që do të transportohet. Nëse nuk është kështu, detyrimi për transport nuk është i zbatueshëm. Në raste të tilla, rimbursimi i tarifës përjashtohet.

5.8 Fëmijët e moshës 5 - 15 vjeç transportohen vetëm nëse shoqërohen nga një kujdestar i rritur apo edhe me përcjellje të stjuardesës “ UM “(shërbim me pagesë). Fëmijët e pashoqëruar duhet të regjistrohen tek Reiseburo Prishtina sh.p.k. të paktën 48 orë para nisjes, përndryshe transporti nuk është i garantuar. Në këto raste, gjithashtu duhet të rezervohet shërbimi i përcjelljes për fëmijët tek linjat ajrore që operojnë. Në disa shtete, fëmijët dhe adoleshentët nën moshën 18 vjeç duhet të paraqesin një formular autorizimi të plotësuar nga kujdestari i tyre ligjor në mënyrë që t'mund të largohen nga vendi i tyre. Çdo pasagjer është përgjegjës për respektimin e këtyre rregullave. Rimbursimi i tarifës përjashtohet në rast të mospërmbushjes së këtyre kërkesave për hyrje/dalje, të cilat për pasojë rezultojnë në refuzimin e udhëtimit të pasagjerit.

5.9 Transporti i foshnjave (deri në 2 vjeç) është subjekt i regjistrimit për udhëtim. Koha e nisjes është vendimtare për përcaktimin e moshës së fëmijës. Në rastin e fluturimeve të rezervuara për vajtje dhe kthim, mosha në datën e fluturimit të kthimit është përcaktuese e jo në datën e nisjes apo shkuarjes.

5.10 Transporti i personave me aftësi të kufizuara, grave shtatzëna, personave të sëmurë që kërkojnë ndihmë të veçantë i nënshtrohet respektimit të rregullave të veçanta të transportit të përcaktuara nga linja ajrore operuese.

5.11 Transporti i kafshëve është i mundur vetëm me aprovimin e konfirmuar të linjës ajrore që operon. Njoftimi duhet të jepet të paktën 48 orë para nisjes.

6. Ndryshimet e dates së udhëtimit – rezervimit / Anulimet e biletave

6.1. _Ndryshimi i datës së udhëtimit mund të bëhet më së voni 3 ditë (72 orë) para fluturimit, me pagesë shtesë sipas çmimit aktual në sistem (diferenca në mes të çmimit kur është blerë bileta dhe çmimit aktual , nëse ka ndonjë diferencë të tillë), por përveq kësaj aplikohet një tarifë shtesë prej 20 €/20 CHF (tarifë e riprenotimit) për një drejtim për secilin rezervim. Nëse kërkohet ndryshim i datës në periudhën kohore brenda 3 ditëve para fluturimit, bileta mund të vendoset në shitje në sistemin me çmimin aktuale dhe nëse shitet vendi atëherë mundësohet ndryshimi i datës ku aplikohet diferenca e çmimit së bashku me tarifën e riprenotimit të cekur më lartë.

6.2._Ndryshimi i emrit te pasagjerit mund të bëhet më së voni 2 orë para kohës së nisjes së fluturimit (kjo vlenë vetëm për biletat njëdrejtimshe , përderisa te biletat kthyesë emri apo mbiemri mund të ndryshohet vetëm para shfrytëzimit të segmentit të parë - nisjes e asesi vetëm në segmentin e kthimit) Çdo ndryshim emri apo mbiemri mund të bëhet duke paguar diferencën në mes te çmimit me te cilin është rezervuar dhe çmimit aktual (nëse ka nje diferencë të tillë) përveq kësaj aplikohet edhe një tarifë shtesë 30 €/30 CHF (tarifë për ndrshyshim emri) . I vetmi rast kur perjashtohet pagesa e diferencës së çmimit në rast ndryshimi emri apo mbiemri është kur bëhet përmirësimi i më së shumti 3 shkronjave.

6.3._Anulimi I rezervimit mund të bëhet, por një veprim I tillë nga ana e pasagjerit duhet të bëhet konform rregullores së Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. Vendimtare është koha kur kërkohet të bëhet anulimi , sa ditë , sa orë para nisjes apo sa ditë apo orë nga koha kur është bërë rezervimi e ku aplikohen shkallët e dëmshpërblimit , ndalesës si në vijim:

- Për rezervimet e bëra më shumë se 30 ditë para fluturimit, anulimi pa ndonjë ndalesë mund të bëhet më së voni 7 ditë nga data e rezervimit. Pas këtij afati kohor 85 % e shumës së paguar rimbursohet që nënkupton 15 % e shumës së paguar ndalet.
- Për rezervimet e bëra 15–29 ditë para fluturimit, anulimi pa ndonjë ndalesë mund të bëhet më së voni 4 ditë nga data e rezervimit. . Pas këtij afati kohor 75 % e shumës së paguar rimbursohet që nënkupton 25 % e shumës së paguar ndalet.
- Për rezervimet e bëra 7–14 ditë para fluturimit, anulimi pa ndonjë ndalesë mund të bëhet më së voni 3 ditë nga data e rezervimit. . Pas këtij afati kohor 65 % të shumës së paguar rimbursohet që nënkupton 35 % e shumës së paguar ndalet.
- Për rezervimet e bëra 3–6 ditë para fluturimit, anulimi pa ndonjë ndalesë mund të bëhet brenda ditës së rezervimit. . Pas këtij afati kohor 55 % të shumës së paguar rimbursohet që nënkupton 45 % e shumës së paguar ndalet.
- Për rezervimet e bëra 24–72 orë para fluturimit, anulimi pa ndonjë ndalesë mund të bëhet brenda 4 ore nga momenti i rezervimit. . Pas këtij afati kohor 20 % e shumës së paguar rimbursohet që nënkupton 80 % e shumës së paguar ndalet.

Të gjitha anulimet apo ndryshimet mund të bëhen vetëm sipas kushteve të mësipërme. Në çdo rast tjetër, rezervimet mbeten të konfirmuara dhe nuk mund të anulohen apo të ndryshohen.

7. Koha për regjistrim (Check-in) dhe pasojat e vonesave

Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. i këshillon pasagjerët që të paraqiten tek sporteli përkatës (check in) për përgatitje të pasagjerëve më së voni 120 minuta (2 orë) para nisjes. Sporteli (check in) mbyllet 50 minuta para kohës së nisjes së fluturimit. Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. nuk mban përgjegjësi për paraqitje të mëvonshme , pasagjeri mbanë përgjegjësi për arritjen jo në kohë.

8. Konfirmimi i kthimit

Çdo klient i Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. është i detyruar ta konfirmojë kthimin e tij të planifikuar brenda 24 deri 48 orëve, nëpërmjet telefonit tek Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. Konfirmimet e

kthimeve mund të bëhen në numrat e telefonit që gjenden në biletë. Nëse nuk e konfirmoni kthimin dhe ai ju humb, atëherë shuhet e drejta për fluturim.

9. Bagazhi dhe dokumentacioni

Rregullat e bagazheve ndryshojnë në varësi të linjës ajrore. Zbatohen rregulloret e linjave ajrore që operojnë. Duhet të respektohen rregullat për bagazhet e dorës së fluturimit dhe rregullat aktuale të sigurisë.

10. Përgjegjësia për dëmet

Përgjegjësia për dëmtimin e pasagjerëve, bagazheve dhe mallrave, si dhe dëmet për shkak të vonesave, refuzimit për boarding dhe anulimeve, zbatohet në bazë të rregulloreve të linjave ajrore që operojnë ose legjislacionit të aplikueshëm. Çdo pretendim, njoftim për dëmtim ose ankesë duhet t'i bëhet me shkrim linjës ajrore që operon. Regjistrimi i mundshëm i një raporti dëmi në aeroport ose në Reiseburo Prishtina sh.p.k. nuk zëvendëson njoftimin me shkrim me kohë të linjës ajrore që operon.

Për përmbushjen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secili pasagjer e mban përgjegjësinë për vete. Pasagjeri duhet të marrë vetë përsipër çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërmbushjes së këtyre rregullave.

11. Lirime për fëmijë dhe foshnje.

Fëmijët deri në 2 vjeç (pa të drejtë kërkesë për ulëse) dhe të fëmijët deri në moshën 11 vjeçare paguajnë një çmim më të lirë. Me rëndësi është moshë e fëmijës gjatë në kohën , datën e fluturimit. Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. e ka të drejtën që para nisjes ta kontrollojë moshën e fëmijës dhe ta ngritë tarifën përkatëse.

12. Tjetërsimi

Tjetërsimet e kërkesave kundër Reiseburo Prishtina International Sh.p.k. janë të paefektshme.

13. Reklamimet / Ankesat

Reklamimet ,ankesat mund të bëhen vetem në mënyrë të shkruar menjëherë pas përfundimit të fluturimit tek Shërbimi ndaj klientëve I Reiseburo Prishtina International Sh.p.k në email adresën: customer.service@flyrbp.com

14. Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit është Prishtina.

15. Klauzola salvatoriane

Në qoftë se klauzola të veçanta të rregulloreve të dala janë tërësisht apo pjesërisht të paefektshme, atëherë validiteti i rregulloreve të tjera mbetet i paprekur nga kjo. Rregullorja e paefektshme zëvendësohet me një rregullore, e cila për nga qëllimi dhe kuptimi i rregullores së paefektshme është më e përafërt juridikisht dhe ekonomikisht.

16. Qëndrimi

Këto kushte i përkasin qëndrimit të datës 12.01.2026.